



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr 1287/ 5 prot.

Datë 28.07.2022

V E N D I M
Nr. 726/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.07.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekti:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “A&A Security Survey” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me nr REF-27362-05-04-2022 me objekt: “Blerje aparate reader për kryerjen e leximeve të ujëmatësave”, me fond limit 7,773,333 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 16.05.2022 nga autoriteti kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SHA.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “A&A Security Survey” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me nr REF-27362-05-04-2022 me objekt: “Blerje aparate reader për kryerjen e leximeve të ujëmatësave”, me fond limit 7,773,333 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 16.05.2022 nga autoriteti kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SHA.

Ankimues:

Operatori ekonomik “A&A Security Survey” SHPK
Adresa: Rruga “Lord Bajron”, Vila Nr. 1, Tiranë.

- Autoriteti Kontraktor:** Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SHA.
Adresa: Rruga “Kavajës”, Nd. 133, Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë.
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Atom” SHPK
Adresa: Rruga “Islam Alla”, Pallati nr. 56, Kati. 1, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11-05-2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me nr REF-27362-05-04-2022 me objekt: “*Blerje aparate reader për kryerjen e leximeve të ujëmatësave*”, me fond limit 7,773,333 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 16.05.2022 nga autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë SHA.

II.2. Në datën 10.06.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3 Në datën 27.05.2022 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “A&A Security Survey” SHPK skualifikuar	6,300,000	lekë
2. “Ligus” SHPK skualifikuar	7,260,000	lekë
3. “Atom” SHPK kualifikuar	7,468,000	lekë
4. “Lumacom” SHPK skualifikuar	7,580,600	lekë

II.4. Më datë 27.05.2022 autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike ka njoftuar operatorin ekonomik “A&A Security Survey” ShPK për vlerësimin e procedurës së prokurimit nga ku rezulton, se ky operator ekonomik është skualifikuar me arsyet si më poshtë vijojnë:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 80, neni 92/3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar neni 82 si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik nga të cilët rezulton si më poshtë vijon:

Së pari AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në sistemin elektronik katalogun/et/ ose fragmente të katalogut të prodhuesit të mallrave objekt prokurimi ose skedat teknike të prodhuesit.Në rast se katalogjet apo skedat teknike janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe sipas legjislacionit në fuqi. Katalogu ose skedat teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të artikullit të kërkuar me qëllim që AK të

gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara. Në përmbushje të dokumentacionit të kërkuar nga AK operatori ekonomik ka paraqitur një pjesë katalogu të prodhuesit Chainëay në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe.

Nga verifikimi i katalogjeve të mësipërme Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se katalogu i paraqitur në gjuhën shqipe nuk rezulton të jetë i përkthyer nga një përkthyes zyrtar. Në mbështetje të ligjit nr.82/2021, datë 24.06.2021 “Për Përkthimin Zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar” neni 6 pika citohet

1. Shërbimi i përkthimit zyrtar në Republikën e Shqipërisë kryhet vetëm nga përkthyesit zyrtarë të certifikuar në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

3. Çdo përkthim zyrtar përmban: a) përkthimin e saktë të tekstit nga gjuha e burimit në gjuhën e synuar dhe anasjelltas, të shoqëruar me vulën e përkthyesit zyrtar që ka kryer përkthimin; b) deklaratën e nënshkruar prej përkthyesit zyrtar të certifikuar se e ka përkthyer atë me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore.

4. Mungesa e vulës ose e deklaratës tip të nënshkruar prej përkthyesit zyrtar sipas pikës 3 të këtij neni, e bën përkthimin të pavlefshëm. Forma dhe përmbajtja e deklaratës që i bashkëlidhet çdo përkthimi zyrtar miratohen me urdhër të ministrit. Përsa cituam më lart dokumentacioni i paraqitur në gjuhën shqipe do të konsiderohet i pasaktë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Gjithashtu edhe nëse Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të konsiderontë të vlefshëm paraqitjen e katalogut në gjuhën shqipe KVO vëren se në katalogun e prodhuesit pesha e mallit objekt prokurimi është 370 g ndërkohë që në specifikimet teknike të kërkuara nga AK është max 300g.

Ju bëjmë me dije se paraqitja e katalogut të mallrave është e nevojshme për AK me qëllim verifikimin e specifikimeve teknike të kërkuara nga AK me qëllim krijimin e bindjes se operatori i përzgjedhur do të furnizojë me mallra sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga vetë AK dhe për rrjedhojë kontrata do të realizohet me sukses.

Në DST parashikohet shprehimisht Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 80, neni 92/3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik”, dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar Neni 79, neni 80, neni 82 e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderi.

II.5. Në datën 14.06.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim-Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike, si dhe ka publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 80, me datë 20.Qershor.2022.

II.6. Në datën 16.06.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me nr. 1287/2022 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2285 e operatorit ekonomik “A&A Security Survey” SHPK me anë të së cilës kundërshton vendimin e Komisionit Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1287/2 Prot., date 17.06.2022 duke referuar arsyet mbi skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.8. Me shkresën nr. 8693/18 prot, datë 29.06.2022 protokolluar me tonën me nr. 1287/4 prot datë 01.07.2022, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni përkatës i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe vendimi për trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “A&A Security Survey” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimuesit.

II.9. Referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit me shkresën nr. 8693/13 prot., datë 29.06.2022 ka vendosur: “ [...] Të pranojë pjesërisht pretendimet e ngritura në Formularin e Ankesës elektronike me nr. A/2022/2285, datë 16.06.2022 nga operatori ekonomik “A&A Security Survey” ShPK, lidhur me përmbushjen e pikës 3.4 të kushteve të veçanta të kualifikimit lidhur me paraqitjen e katalogut operatori ekonomik ankimues ka paraqitur katalog të produktit në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Referuar dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe pretendimeve të ngritura në formularin e ankesës mbi paraqitjen e katalogut në gjuhën shqipe, KSHA gjykon se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë dhe për rrjedhojë pranohet. [...]”.

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr.162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatori ekonomik “A&A Security Survey” ShPK mbi vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me shkresën nr. 8693/18 prot, datë 29.06.2022 protokolluar me tonën me nr. 1287/4 prot datë 01.07.2022, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni përkatës i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe vendimi për trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “A&A Security Survey” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimuesit. Referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit me shkresën nr. 8693/13 prot., datë 29.06.2022 ka vendosur:

“ [...] Të pranojë pjesërisht pretendimet e ngritura në Formularin e Ankesës elektronike me nr. A/2022/2285, datë 16.06.2022 nga operatori ekonomik “A&A Security Survey” ShPK, lidhur me përmbushjen e pikës 3.4 të kushteve të veçanta të kualifikimit lidhur me paraqitjen e katalogut operatori ekonomik ankimues ka paraqitur katalog të produktit në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Referuar dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe pretendimeve të ngritura në formularin e ankesës mbi paraqitjen e katalogut në gjuhën shqipe, KSHA gjykon se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë dhe për rrjedhojë pranohet. [...]”.

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 1287/2022 prot, datë 16.06.2022 dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2285 e operatorit ekonomik “A&A Security Survey” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “A&A Security Survey” SHPK, mbi vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij me arsyet: “Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 80, neni 92/3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar neni 82 si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik nga të cilët rezultoi si më poshtë vijon: Së pari AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon: 3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në sistemin elektronik katalogun/et/ ose fragmente të katalogut të prodhuesit të mallrave objekt prokurimi ose skedat teknike të prodhuesit. Në rast se katalogjet apo skedat teknike janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe sipas legjislacionit në fuqi. Katalogu ose skedat teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të artikullit të kërkuar me qëllim që AK të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara. Në përmbushje të dokumentacionit të kërkuar nga AK operatori ekonomik ka paraqitur një pjesë katalogu të prodhuesit Chainëay në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Nga verifikimi i katalogjeve të mësipërme Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se katalogu i paraqitur në gjuhën shqipe nuk rezultoi të jetë i përkthyer nga një përkthyes zyrtar. Në mbështetje të ligjit nr.82/2021, datë 24.06.2021 “Për Përkthimin Zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar” neni 6 pika citohet 1. Shërbimi i përkthimit zyrtar në Republikën e Shqipërisë kryhet vetëm nga përkthyesit zyrtarë të certifikuar në përputhje me parashikimet e këtij ligji. 3. Çdo përkthim zyrtar përmban: a) përkthimin e saktë të tekstit nga gjuha e burimit në gjuhën e synuar dhe anasjelltas, të shoqëruar me vulën e përkthyesit zyrtar që ka kryer përkthimin; b) deklaratën e nënshkruar prej përkthyesit zyrtar të certifikuar se e ka përkthyer atë me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore. 4. Mungesa e vulës ose e deklaratës tip të nënshkruar prej përkthyesit zyrtar sipas pikës 3 të

këtij neni, e bën përkthimin të pavlefshëm. Forma dhe përmbajtja e deklaratës që i bashkëlidhet çdo përkthimi zyrtar miratohen me urdhër të ministrit. Përsa cituam më lart dokumentacioni i paraqitur në gjuhën shqipe do të konsiderohet i pasaktë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm. Gjithashtu edhe nëse Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të konsiderontë të vlefshëm paraqitjen e katalogut në gjuhën shqipe KVO vëren se në katalogun e prodhuesit pësha e mallit objekt prokurimi është 370 g ndërkohë që në specifikimet teknike të kërkuara nga AK është max 300g. Ju bëjmë me dije se paraqitja e katalogut të mallrave është e nevojshme për AK me qëllim verifikimin e specifikimeve teknike të kërkuara nga AK me qëllim krijimin e bindjes se operatori i përzgjedhur do të furnizojë me mallra sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga vetë AK dhe për rrjedhojë kontrata do të realizohet me sukses. Në DST parashikohet shprehimisht Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 80, neni 92/3të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik”, dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar Neni 79, neni 80, neni 82 e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimet teknike” të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektornike përcaktohet si më poshtë:

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Procesori, “Processor”:	min. 8 cores, 1.8GHz, at least Qualcomm SD660 ose ekuivalent
Memorja, “RAM”:	min. 3GB RAM / 32GB internal flash
Kamera, “Camera”:	min.13 Mega Pixel kamera e prapme
Sistemi Operativ, “Operating System”	Android 11, me mundësi deri në Android 14
Bateria, “Battery”:	min. 3500mAh
Ekrani, “Display”:	min 4” ËVGA, LED backlight, optically bonded, multitouch, Corning Gorilla glass
Imazheria, “Imager”	1D/2D standard range imager i mbrojtur me teknologjinë Corning Gorilla glass
Tastiera, “Keypad”:	tastiere numerike me 34 tasta dhe me funksionet Fn
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Rrjeti ËLAN, “ËLAN Netëork”:	IEEE 802.11 a/b/g/n/ac/d/h/i/r/k/v; Ëi-Fi™ certified; MU-MIMO
Bluetooth, “Bluetooth”:	Klasi 2, Bluetooth v5.0, me BR/EDR dhe Bluetooth Loë Energy support
NFC. “NFC”:	ISO14443 Type A and B: FeliCa and ISO 15693 cards. P2P mode and Card Emulation via Host (HCE) support
Nderfaqet, “Interfaces”:	USB 2.0 Host dhe Klient
OPSIONET	
Sensorët, “Sensors”:	Sensor Drite Sensor Levizjeje Sensor Afërsie
Lexuesi i të dhënave, “Data Capture”:	1D dhe 2D imager i integruar NFC
Diagnostikimi, “Diagnostics Options”:	Aplikacioni i integruar i diagnostikimit, i zhvilluar nga prodhuesi i pajisjes, pa pagese.
Siguria, “Security”:	Të jetë i aftë të ndalojë aksesin tek “parametrat e pajisjes”, të kontrollojë aksesin tek aplikacionet dhe të mundësoje kufizimin e përdorimit të një aplikacioni të vetëm, pa kosto shtesë
Fortësia, “Durability”:	Standardi IP65, Rezistencë nga 1,52m në beton sipas standardit MIL-STD 810G Vibrimi - 4 g’s PK sinusoidal (5 Hz to 2 kHz); 0.04 g 2/Hz Random (20 Hz to 2 kHz); 60 minuta per aks, 3 akse, shkarkimi

	ESD - +/- 15kv; +/- 8k direkt dhe indirekt
Ambjenti i perdoruesit, “User Environment”:	Temperatura e operimit -20°C to 50°C Temperatura e magazinimit -40°C to 70°C Lagështia - 5% to 95% jo e kondensuar
Staging, “Staging”:	Aplikacion i preinstaluar, pa kosto shtese per te konfiguruar pajisjet ne grup duke perdorur konfigurimet e barkodeve, te jete zhvilluar nga prodhuesi i pajisjes
Opsione te tjera, “Additional features”:	Te jete i afte te konfigurohet qe te zgjedhe nje barkod unik edhe pse ne fushepanje mund te kete edhe barcode te llojeve te ndryshme
Pesha, “Eeight”:	max. 300g me baterinë e vendosur
AKSESORET	
Karikuesi “Charger”:	Po, European, shoqeruar me kabllot përkatës
Gomina Mbrojtëse “Protective Cover”:	Po, European, e të njëjtës markë me kompjuterin mobile
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Earranty”:	1 Vit

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “A&A Security Survey” SHPK në përmbushje të kriterit dhe specifikimeve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Autorizim Prodhuesi të datës 10.05.2022, nga Shenzhen Chinaeü Information Technology Co., Ltd.
- Katalogun e Prodhuesit në Gjuhën Shqipe.
- Deklaratë mbi Specifikimet dhe Garancinë.

III.2.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.4. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë*

e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.2.6. Në nenin 40 pika 1, 2 dhe 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me

kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.2.7. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa

sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”

III.2.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.9. Në përfundim, sa më sipër analizuar, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitura nga operatori ekonomik ankimes, përcaktimeve të bëra nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit shtojca 5 “*Formulari i Specifikimeve Teknike*” ku ka përcaktuar “**Karakteristika Minimale Teknike**”, pesha 300 g KPP gjykon se, operatori ekonomik ankimes “*A&A Security Survey*” SHPK, referuar shtojca 5 “*Formulari i Specifikimeve Teknike*” ku është përcaktuar “**Karakteristika Minimale Teknike**”, nëpërmjet katalogut të paraqitur për produktin objekt prokurimi vërteton se do të ofrojë në këtë procedurë prokurimi produktin “*aparaturë*”, në përputhje me “**Karakteristika Minimale Teknike**”, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Produkti i ofertuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes referuar katalogut rezulton me peshë 370 g. KPP konstaton se dokumentacioni katalogë teknike dëshmon qartë se artikulli i mësipërcituar evidentohet në katalog dhe është në përputhje me specifikimet teknike që ka parashikuar dhe autoriteti kontraktor në shtojcën 5 “*Formulari i Specifikimeve teknike*”, “**Karakteristikat Minimale Teknike**”, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se operatori ka ofertuar një produkt me peshë 370 g dhe jo më pak nga sa ka përcaktuar autoriteti në shtojcën 5 “**Karakteristika Minimale Teknike**” të produktit. Në këtë kuptim KPP gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimes se operatori ekonomik “*A&A Security Survey*” SHPK i renditur i pari ka ofertuar një produkt në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST, pasi në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik shprehen qartë në katalogjet teknike specifikimet e artikullit në përputhje dhe mbi karakteristikat minimale teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Vlen të theksojmë se, në respekt të parimeve të ligjit për prokurimin publik, specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë /përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi operatorit ekonomik ankimes “*A&A Security Survey*” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimesi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe*

Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “A&A Security Survey” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me nr REF-27362-05-04-2022 me objekt: “Blerje aparate reader për kryerjen e leximeve të ujëmatësave”, me fond limit 7,773,333 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 16.05.2022 nga autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë SHA.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “A&A Security Survey” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “A&A Security Survey” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri